

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, Gjyqtari Berat Spahiu, me sek. juridike Xhemile Bejtullahu, në çështjen kontestimore të paditësve B. A nga fshati P dhe M.A nga fshati P. te cilët i përfaqëson A. I., kundër të paditurve L: A. nga fshati P. te cilën e përfaqëson S. Ri av nga Gjilani, N. A, N. A, Sh. A, F. A, K. A, D. A, L. A, A. A., R. A., H. A, Sh. A, R. A dhe A. A. qe te gjithë nga fshati P te cilët i përfaqëson për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, pas mbajtjes se seancës gjyqësore, me datë 15.09.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M
Në Bazë të Pohimit

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësvenga fshati P.. e ushtruar kundër të paditurve...., trashëgimtare ligjore e te ndjerit....., , Komuna e Gjilanit, per shkak te vërtetimit te se drejtës se pronësisë, dhe

I. VËRTETOHET ndaj të paditurve...., , si trashëgimtare ligjor e të ndjeritjuridik te te ndjeritM:A , se paditësit në bazë të ndarjes se bashkësisë ekonomike dhe familjare janë pronarë juridik nga ¼ te njesise kadastrale P-.....per ZK e cila gjendet ne vendin e quajtur "" e cila evidentohet sipas Çertifikates Pronësore me nr te lendes 8245-2016, si dhe nga 1/6 te njësisë kadastrale , për ZK. Gjilan, e cila gjendet në vendin e quajtur "" e cila evidentohet sipas Çertifikates Pronësore me nr te lendes.....

II. Detyrohen paditësit që kësaj gjykate t'ia paguaj shumen e të hollave në lartësi prej 100€, në emër të përpilimit me shkrim të këtij vendimi, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit, nën kërcenimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësitnga fshati P., në këtë gjykatë kane ushtruar padi, kundër të paditurvenga fshati P..... Komuna e...., si trashëgimtar ligjor te te ndjerit M.A ish nga P..... me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se paditësit janë pronarë juridik nga ¼ te njesisë kadastrale P- per ZK Gjilan, e cila gjendet ne vendin e quajtur "...” e cila evidentohet sipas Çertifikates Pronësore me nr te lendes 8245-2016, si dhe nga 1/6 te njësisë kadastrale ,Gjilan, e cila gjendet në vendin e quajtur “” e cila evidentohet sipas Çertifikates Pronësore me nr te lendes 8244-2016.

E paditura L.K ne baze te deklaratës se datës, nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se janë të vërteta pretendimet e paditësve për njohjen e të drejtës së pronësisë nga ¼ në sipërfaqe preje cila gjendet në vendin e quajtur “ Bashte” e cila evidentohet sipas Njësisë kadastrale , P 70403013-02285-0 për ZK. Gjilan, per arsye se babai saj ka qene vetëm pronar juridik por jo edhe faktik, pasi qe pronar faktik janë Bajram dhe M.A qe te dy nga P.... ne baze te ndarjes se bashkësisë ekonomike dhe familjare para 30 vitesh nga ¼ te pjesës ideale dhe nuk e konteston dhe e pranon pronësinë e tyre dhe pjesës nga 1/6 ne sipërfaqe prej 3001 m2, e cila gjendet ne vendin e quajtur "" e cila evidentohet sipas njesise kadastrale P70403013-01103-0, per arsye se babai i saj i ndjere M. A, ka qene pronar juridik por jo edhe faktik i (2/6), pjese ideale pasi qe para 30 vitesh me

rastin e ndarjes se bashkësisë ekonomike dhe familjare, pjesa ideale prej (2/6) ju ka takuar dhe nga P. nga 1/6 te pjesës ideale.

Lidhur me këtë qeshtë gjykata ka caktuar shqyrtim gjyqësor, ku përfaqësuesit e te paditureve kane pohuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve.

Gjykata pas analizimit të pretendimeve të paditësve të paraqitura në padi dhe provat materiale të bashkëgjitura padisë si dhe pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurve, ka konstatuar se palët mund të disponojnë me të drejtat lidhur me objektin e kontestit dhe se të njëjtat nuk janë në kundërshtim me ligjin apo me rendin juridik, ashtu që duke u bazuar në nenin 148.1 të LPK-së , aprovoi kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar me ligj dhe mori Aktgjykim në Bazë të Pohimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mori në bazë të nenit 452 pika 4. të LPK.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e bazuar në nenin 143 dhe 148 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykatësi,
Ma. Sc.lur Berat Spahiu**

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të të njëjtit, vetëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.*